



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Primal / Dostigat Punjava / Prindaja Received / Dostigat	10.02.2022	2	viti god year
Organ / Ispost Organ / Odgovor Org / Unit	Dr. Prita Dr. Prita Prof. No.	Shkronja Kod Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRONJSHKON	671/2022		1/1



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.19/2022**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji** për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi -Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, sipas Aktgjykimit A.nr.887/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.80/2019 të datës 08.02.2019 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson me adresë në Prishtinë, kundër Vendimit me Nr. prot:05-98 të datës 10.01.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Shëndetësisë, në çështjen juridike “Ndërprerjeje e marrëdhënies se punës në Shërbimin Civil”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovë dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 10.02.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**Përfundon Procedimi Administrativ** i iniciuar me ankesën me numër A.nr.80/2019 e datës 08.02.2019 të parashtruar nga ankuesi

**A r s y e t i m**

Ushtruesi i detyrës së Drejtorit të SISH pranë Ministrisë së Shëndetësisë, me datën 10.08.2018, me numër protokolli 05-5382 ka përgatitur raportin për vijueshmërinë në punë për Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Udhëheqësin e Personelit të Ministrisë së Shëndetësisë, me të cilin ka dhënë arsyetimin se “ka bërë shkelje të rënda serioze të detyrave të punës duke “bërë hyrje dalje fiktive nga puna -duke u regjistruar Koleget për njeri tjetrin dhe pasi kanë vërejtur se është duke u regjistruar nga kamerat e sigurisë të njëjtit kanë lëvizur kamerën e sigurisë nga vendi”, duke rekomanduar që lënda të kalojnë Komisioni Disiplinor sipas rregullores përkatëse.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Shëndetësisë pas mbajtjes së seancës më datë 04.09.2018 ka nxjerr Vendim me Nr. 01/IX/2018 me numër protokolli 05-5906 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore “Ndërprerjeje e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil”.

Ankuesi, i pakënaqur me Vendimin me Nr. 01/IX/2018 me numër protokolli 05-5906 të datës 04.09.2018 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë, me datën 20.09.2018 ka parashtruar



ankesë me numër protokoll 05-6282 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave tek Ministria e Shëndetësisë. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Shëndetësisë, nuk ka nxjerr vendimin lidhur me ankesën e ankuesit.

Ankuesi përmes përfaqësuesit të tij e pakënaqur Vendimin me Nr. 01/IX/2018 me numër protokoll 05-5906 të datës 04.09.2018 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovë dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.11.2018 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 6891/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 20.11.2018, ka dërguar kërkesën për përgjigje në aneksen e ankuesit tek Ministria e Shëndetësisë, ndërsa me datën 23.11.2018 me numër protokoll 7116/2018, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Shëndetësisë, me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.12.2018 nxjerr Vendim A.nr.748/2018 me të cilin ka detyruar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Shëndetësisë që të bëjë shqyrtimin e ankesës së datës 20.09.2018 të ankuesit

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Shëndetësisë, duke u bazuar në vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.01.2019 ka nxjerr Vendim me Nr. prot:05-98 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit duke lënë në fuqi vendimin e Komisionit Disiplinor.

Ankuesi e pakënaqur me Vendimin me Nr. prot:05-98 të datës 10.01.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Shëndetësisë, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovë dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.02.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 692/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 26.03.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative më datë 11.01.2022 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.887/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 26.03.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankueses të datës 08.02.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 80/2019 të datës 08.02.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. prot:05-98 të datës 10.01.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Shëndetësisë; Ankesën me numër protokoll 6891/2018 të datës 19.11.2018 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 01/IX/2018 me

numër protokollit 05-5906 të datës 04.09.2018 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë; Ankesën me numër prot: 05-6282 të datës 20.09.2018 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Autorizimin e datës 12.11.2018; Akt Emërimit të datës 01.10.2013 të ankueses; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 25.01.2016 dhe i datës 05.01.2018; E-mailin e datës 20.08.2018 të për ankuesin; Procesverbalin e datës 20.08.2018 dhe 04.09.2018 të Komisionit Disiplinor; Shkresën për dërgimin e lëndës në Komisionin e Ankesave e datës 24.09.2018; Raporti për vijueshmërinë në punës i datës 10.08.2018; Raporti i prezencës në punë për periudhën 01.08.2018 deri me 09.08.2018; E-mailin e datës 10.09.2018 të për Procesverbalin e takimit të Komisionit disiplinorë lidhur me rastin e pretendimeve për shkelje disiplinore te supozuar të datës 04.09.2018; Dy CD; Procesverbal i Kolegjit për Ankesa i datës 26.12.2018 ; Vendimin A.nr.748/2018 të datës 26.12.2018 të Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Përgjigjen në kërkesë e datës 21.11.2018; Aktgjykimit A.nr.887/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Njoftimin e datës 26.03.2019; E-mailin e datës 09.02.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; Njoftimin e datës 07.05.2019 me numër prot:05-2216.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit është bërë i pamundur, *sepse*:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore se Vendimi i datës 10.01.2019 me numër Nr. prot:05-98 i Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Shëndetësisë është i kundërligjshëm pasi që kishte refuzuar ankesën e ankuesit të datës 20.09.2018 ndërsa kishte lënë në fuqi Vendimin Nr.prot:05-5906 të Komisionit Disiplinor të datës 04.09.2018 me arsyetimin se shqiptimi i masës disiplinore “Ndërprerje e Marrëdhënies së Punës në Shërbimi Civil” është bërë në kundërshtim me dispozitat e aplikuara të Ligjit për Shërbimin Civil dhe akteve tjera nënligjore si dhe në kundërshtim me Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me datë 09.02.2022 përmes e-maili Këshilli i është drejtuar Menaxherit të Njesisë së Burimeve njerëzore të Ministrisë së Shëndetësisë me qëllim të konstatimit të gjendjes faktike pasi që lënda ishte kthyer në detyrim me vendos sipas Aktgjykimit A.nr.887/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative lidhur me ankesën e ankuesit, ndërsa Menaxherit i Njesisë së Burimeve Njerëzore përmes e-mailit të datës 09.02.2022 ka informuar Këshillin se ankuesi me datë 07.05.2019 ka informuar Drejtorin e SISh përmes shkresë me numër protokollit:05-2216 se ka dhanë dorëheqje të parevokueshme nga pozita “Administrator për Kualitet dhe Siguri”.

Këshilli, pas krijimit të rrethanave të reja lidhur me objektin e shqyrtimit ka analizuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht nenit 104 ku është përcaktuar se: “Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”, andaj në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji konstaton se procedura administrative e iniciuar nga ankuesi përmes ankesës me numër A.nr.80/2019 të parashtruar me datë 09.02.2019 është bërë i pamundur apo i kotë, respektivisht objekt i shqyrtimit “Ndërprerja e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil e ankuesit” tani më është bërë i pamundur të shqyrtohet pasi që ankuesi me datë 07.05.2019 në mënyrë deklarative përmes shkresë së protokolluar me numër:05-2219 rezulton të ketë dhënë dorëheqje nga pozita e nëpunësit civil që ka mbajtur në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi




Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.19/2022**

**Flakron GASHI**



*Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional*



***Vendimi i dërgohet:***

- Përfaqësuesit të ankueses, Firmës së Avokatisë
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Shëndetësisë;
- Z. Fisnik Nuli, Gjykatës në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

